



Planuar / Doretuar Punëno / Prodato Received / Delivery	20 . 11	0	viti god year
Organ / Rrjeta Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPMSTEK	2692/2020		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr. 281/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi – Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani, anëtar Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A. Nr.281/2020, të datës 23.09.2020, të parashtruar nga ankuesi ██████████, f.sh. Letanc'' Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike " Mase disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 19.11.2020, mori këtë

### V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa A. Nr. 281/2020, e datës 23.09.2020, e parashtruar nga ankuesi ██████████.

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 13-104/02-0039912/20, i datës 25.08.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës, si dhe Vendimi me numër protokoll 13-116/01-0034289/20 i datës 07.07.2020 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Podujevës.

III. OBLIGOHET Kryetrari i Komunës së Podujevës dhe Menaxheri i Personelit, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Me datë 11.06.2020 Drejtori i Administratës me shkresën me numër protokoll 13-116/01-00273170/20, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit ██████████, për shkak se me



datë 11.06.2020 pas mosmarrëveshjeve verbale i njëjti e ka kërcënuar dhe e ka fyer Drejtorin e Administratës në vendin e tij të punës.

Komisioni Disiplinor në Komunën e Podujevës me datë 07.07.2020, ka nxjerr Vendim me numër protokoll 13-116/01-0034289/20, me të cilin i shqipton masën disiplinore "Masën disiplinore Suspendim të Përkohshëm dhe ndalim i pagës i 1/3 pagesës për periudhën kohore prej (2 ) muajve" me pretendimet se ankuesi ka bërë shkelje të rënda serioze të detyrave të punës.

Ankuesi [REDAKTUAR] i pakënaqur me Vendimin e datës 07.07.2020 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës, me datë 28.07.2020 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Podujevës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës, me datë 25.08.2020, nxjerr vendim me numër 13-104/02-0039912/20, me të cilin e refuzoi ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Kundër Vendimit të datës 25.08.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës, ankuesi [REDAKTUAR] me datë 13.06.2018 parashtron ankesë me numër protokoll 3322/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Podujevës, ndërsa me datë 25.06.2018 Komuna e Podujevës ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit për shqyrtimin e ankesave, më datë 06.11.2020 ka nxjerr vendimin VK.nr.16/2020 përmes të cilit ka vendosur të shtyhet afati i vendosjes për ankesën A.nr.281/2020 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën A nr.281 /2020 e datës 23.09.2020, me numër protokoll 1879/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 07.07.2020, i Komisionit Disiplinor; Ankesa drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Procesverbali; Vendimi i datës 25.08.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt Emërimi i datës 01.05.2016; Kërkesa e datës 11.06.2020, për iniciimin e procedurës disiplinore; kërkesë e datës 15.06.2020; Kërkesë e datës 22.06.2020; Vërejtje e datës 26.06.2020; Përgjigja në ankesë e datës 07.10.2020, me numër protokoll 2007/2020, me shkresat e bashkëngjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi dhe organi i punësimit dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] është e bazuar për shkak të shkeljeve procedurale dhe ligjore të bëra nga organi i punësimit.

Kolegji për shqyrtimin e anekseve ka konstatuar se me datë 11.06.2020 Drejtori i Administratës me shkresën me numër protokoll 13-116/01-00273170/20, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit [REDAKTUAR], për shkak se i njëjti pas mosmarrëveshjeve

verbale ka kërcënuar dhe e ka fyer Drejtorin e Administratës në vendin e tij të punës dhe ka propozuar që ndaj ankuesit të shqiptohet masa disiplinore, „Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit deri në pesë (5) vjet”..

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Drejtori i Administratës në Komunën e Podujevës, me rastin e inicimit të procedurës disiplinore përmes kërkesës me numër protokoll 13-116/01-00273170/20 të datës 11.06.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën disiplinore dhe masat disiplinore për nëpunësit civil sepse me dispozitat e Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil nenit 11 paragrafin 5 dhe 12 paragrafin 1 dhe 2 janë përcaktuar kompetencat e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë apo Udhëheqësit me të lartë administrativ të institucionit si në vijim *“Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ose udhëheqësi më i lartë administrativ identifikon detajet e shkeljes dhe vendos se shkelja disiplinore është e natyrës së parëndësishme, shkelje e lehtë apo e rëndë-serioze”* si dhe *„ Nëse Udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze , ne afat prej dy (2) dite pune do ta paraqes rastin me shkrim të Udhëheqësi i Njësisë së personelit”*, *„ Pas marrjes së njoftimit, Udhëheqësi i Njësisë së personelit, shkeljen e dyshuar ia kalon për shqyrtim komisionit disiplinor të institucionit përkatës”*, ndërsa me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 71 paragrafin 1 nënparagrafin, si dhe nenin 13 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, janë përcaktuar kompetencat e Komisionit Disiplinor, si në vijim: *„1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. të dëgjojë provat lidhur me shkeljen e supozuar; 1.2. të vendosë, në bazë të provave, nëse është kryer shkelja; dhe 1.3. përcakton dënimin që duhet shqiptuar”*, sepse në rastin konkret Drejtori i Administratës në Komunën e Podujevës në kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore i ka propozuar Komisionit që ndaj ankuesit të shqiptohet masa disiplinore *„Largim nga zyra dhe transferim në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalim i gradimit deri në pesë (5) vjet”*, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi sepse Udhëheqësi i drejtpërdrejtë pasi konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze ka mandat vetëm ta paraqes rastin me shkrim të udhëheqësi i njësisë së personelit ndërsa Komisioni Disiplinor ka mandat të dëgjoj dhe shqyrtoj provat në lidhje me shkeljen e supozuar dhe të vendos nëse është kryer shkelja e supozuar dhe në bazë të konstatimit të shkeljes së kryer, Komisioni duhet të përcaktojë masën disiplinore për shkeljet e rënda serioze e cila është e përcaktuar me dispozitat e legjisllacionit për shërbimin civil

Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 66 paragrafin 4 nenin 67 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2, ku përcaktohen masat disiplinore për shkelje të rënda-serioze si dhe dispozitat e nenit 8 dhe 9 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ku janë përcaktuar masat disiplinore që mund të shqiptohen ndaj nëpunësve civil për shkelje të rënda-serioze si dhe zyrtarët apo organet përgjegjëse që kanë kompetencë për të shqiptuar masën disiplinore përkatëse, ka konstatuar që në rastin konkret duke u bazuar në provat e lëndës, masa disiplinore e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura, sepse në rastin konkret është shqiptuar masa disiplinore *„Suspendim të Përkohshëm”* që nuk parashihet me dispozitat ligjore.

Duke marrë parasysh faktet e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokoll 13-116/01-0034289/20 të datës 07.07.2020, me të cilin i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore „Suspendim të Përkohshëm dhe ndalim i 1/3 të pagesë për periudhën kohore prej (2 ) muajve”, ka vepruar në kundërshtim me nenin 66 paragrafin 4 dhe nenin 67 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ku thuhet së; „Për shkelje të rënda serioze të përcaktuara me nenin 6 të kësaj Rregulloreje, nëpunësit civil mund t’i shqiptohet këto masa disiplinore, Pezullimi parandalues me pagesë deri në tre (3) muaj në pritje të një hetimi, i cili duhet ti propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion. „Pezullimi i ushtrimit të detyrave dhe ndalim 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Podujevës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 13-104/02-0039912/20 të datës 25.08.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, si dhe nuk ka arritur që të eliminoj shkeljet e bëra me rastin inicimit dhe zhvillimit të procedurës disiplinore si dhe shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit [REDACTED]

Duke marrë parasysh shkeljet e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka vendosur për shfuqizimin e Vendimit me numër 13-104/02-0039912/20, të datës 25.08.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës, si dhe Vendimit me numër protokoll 13-116/01-0034289/20 të datës 07.07.2020 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës, duke i obliguar zyrtarët përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi, kthimin e ankuesit në punës sipas Akt Emërimit të datës 01.05.2016 dhe kompensimin e pagesës së 1/3 të pagesë për periudhën kohore prej (2 ) muajve” me rastin e ndaljes sipas vendimit të komisionit disiplinor.

Organi i punësimit/zyrtarët përgjegjës të Komunës së Podujevës , janë të obliguar që të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me procedurën disiplinore dhe procedurën e ankesave të zhvillojnë duke marrë parasysh dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën dhe afatet ligjore dhe të veprojnë në pajtim me parimet e shërbimit civil që kanë të bëjnë me detyrimin e nëpunësve civil që t’u përgjigjen dhe të reagojnë shpejt ndaj kërkesave, iniciativave ose ankesave të dorëzuara nga individët, organizatat private ose organe të tjera të administratës publike si dhe me parimin që nëpunësit civil duhet t’i ushtrojnë detyrat e tyre në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe në përshkrimin e detyrave të punës në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë dhe pa interes vetjak, në përputhje me interesin publik dhe në përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23



dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda Nr. A. Nr. 281/2020*

**Rushit Kajtazi**

Procesmbajtës

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryetari i Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës;
- Arkivit të KPMSHCK-së